



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2020:146340

Datë: 19.02.2021

Numri i dokumentit: 01520865

P.nr.641/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtës Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurve R. T. nga Mitrovica dhe D.P. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.3659/19 të datës 01.10.2020 (2019:0156184), pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 18.02.2021, në praninë e Prokurorit të shtetit Slllobodan Bakiq, të pandehurve R. T. dhe D. P. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 18.02.2021, me datë **19.02.2021** përpiloj, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI I PARË: R.T., nga i ati R., e ëma F. e vajzërisë H. i lindur me datë ... me vendbanim në Mitrovicë rr: “.2 K.”, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar.

I PANDEHURI I DYTË: D. P., nga i ati O., e ëma H., e vajzërisë G., i lindur me datë ... me vendbanim në Mitrovicë rr: “.E. M.”, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, punon si Auto limar, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa gjykuar.

JANË FAJTORË

SEPSE:

TË PANDEHURIT: R. T. dhe D. P. më 21.10.2019, rreth orës 20:00, në sheshin H. P. afër qebaptores “B.” në Vushtrri, edhe pse ka qenë në gjendje që të kuptojnë rëndësinë e veprës së vet dhe të udhëheqin me veprimet e veta, të vetëdijshëm për veprën, kanë dashur kryerjen e saj, fizikisht e kanë sulmuar dhe i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D. S. me pengesa të përkohshme për shëndetin, në atë mënyrë që me shqelma dhe duar i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore ose pengesa serioze për shëndetin, i pandehuri i parë ka filluar që ta godas me grushte të dëmtuarin nëpër trup, ndërsa i pandehuri i dytë e ka goditur me shqelma dhe grushte nëpër trup e krejt kjo për arsye se në shoqëri së bashku me D.P. B. P.dhe Y. M. i ka kërkuar para për dëmin që e ka shkaktuar në automjetin e shokut të tij Y. M. në çka ai nuk ka pranuar, dhe me atë rast i ka shkaktuar lëndime në formë të ndrydhjes së indeve të buta të nyjës së bërrylit të dorës dhe regjionit lumbal – lëndime të kualifikuara si lëndime të natyrës së lehtë.

- **Me këtë kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje Lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit, 4, 7, 17, 21, 31, 38, 39, 46, 47, 48, 69, 70 dhe nenit 185 të KPRK-së si dhe nenit, 365, dhe 450, dhe 563 të KPPK-së, i

G J Y K O N

TË PANDEHURIT TË PARË: R. T. i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese në afat prej një (1) viti.

TË PANDEHURIT TË DYTË: D.P. i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese në afat prej një (1) viti.

Pala e dëmtuar Driton Sefaja lidhur me këtë çështje penale udhëzohet në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë shumën prej tridhjetë euro (30 €).

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej pesëdhjetë euro (50 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr-3659/19 të datës 01.10.2020 (2019:0156184), kundër të pandehurve R. T. nga Mitrovica dhe D. P. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilën aktakuzë prokurori i shtetit e ka ndryshuar sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe atë në vend të nenit 185 par 2 të KPRK-së sa i përket të pandehurit të parë e ka ndryshuar me nenin 185 par 1 të KPRK-së si dhe sa i përket dispozitivit të aktakuzës duke fshirë dispozitivin II, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 18.02.2021, në këtë seancë të shqyrtimit fillestar i pandehuri i parë R. T. lidhur me fajësinë ka deklaruar se, e pranon fajësinë ne te gjitha pikat e aktakuzës, dhe së është pënduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtojë gjykatës që në të ardhmen që kjo vepër nuk do të përsëritet, dhe i pandehuri i dytë D. P. lidhur me fajësinë ka deklaruar se, e pranon fajësinë ne te gjitha pikat e aktakuzës, dhe së është pënduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtojë gjykatës që në të ardhmen që kjo vepër nuk do të përsëritet.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka deklaruar se jam i pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të përcaktuar me nenin 248 par .1 dhe i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë dhe që

pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, të njëjtit janë penduar thellë për veprën dhe se i kanë premtuar gjykatës se nuk do të përsërisin veprën.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, të pandehurit e kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga të pandehurit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga të pandehurit.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin fillestar

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti i Oficerit i dt. 21.10.2019, në të cilin raport është bërë përshkrimi i rastit se si ka ndodhur, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të viktimës D. S. me nr. 2019-BD-741 i dt. 21.10.2019, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit Benjamin Prebeza me nr. 2019-BD-741 i dt. 21.10.2019, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dyshuarit Riad Tahiri, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dyshuarit D.P. Raporti i Spitalit Sheikh Zayed – Qendra Emergjente në Vushtrri mbi të dëmtuarin Driton Sefaja i dt. 21.10.2019, Akt ekspertimin mjeko – ligjor të datës 13.09.2020, si dhe foto dokumentacion (3) sosh. Andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklaratimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e sanksionuar me dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite, gjykata duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese sa i përket të pandehurit të parë kjo gjykatë ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tyre në kryerjen e veprës penale, dëmin e shkaktuar ndaj të dëmtuarit, të gjitha këto rrethana konsistojnë në inkrimimin e të pandehurve në kryerjen e kësaj vepre penale. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i kanë premtuar gjykatës që nuk do të kryejnë më vepra penale në të ardhmen, ndërsa sa i përket të pandehurit të dytë si rrethanë rënduese kjo gjykatë ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tyre në kryerjen e veprës penale, dëmin e shkaktuar ndaj të dëmtuarit, të gjitha këto rrethana konsistojnë në inkrimimin e të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre penale. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i kanë premtuar gjykatës që nuk do të kryejnë më vepra penale në të ardhmen, dhe se janë pajtuar me palën e dëmtuar, si dhe i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që të pandehurit në të ardhmen të kenë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me vendimin për kompensimin të viktimave të krimit dhe paushallit gjyqësor

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”. Në rastin konkret i dëmtuari nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit fillestar dhe nuk ka sjellë ndonjë dëshmi për dëmin e pësuar material dhe jo material e shprehur në vlerë monetare dhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.641/2020, datë: 19.02.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.